



# Përdorimi i mediave në jetën e përditshme familjare

Këshilla për prindërit




# Të dashur prindër,

në rutinën tuaj të përditshme ju duhet të menaxhoni njëkohësisht një numër të madh sfidash. Kjo sjell shpeshherë situata, të cilat mund të jenë të lodhshme. Herë pas herë ju ndoshta mendoheni gjithashtu, se cilat media mund të jenë edukative ose të çmuara për fëmijët tuaj? Prandaj ndoshta në të dyja rastet ekziston një konflikt ose pasiguri, kur ju u ofroni fëmijëve tuaj media digjitale si celular, tablet, televizor ose kompjuter.

Janë pikërisht këto tema që ka prekur Elbkinder në kuadrin e programit federal “Hyrja në kopshte: Ngritja e urave në arsimin e hershëm” (“Kita-Einstieg: Brücken bauen in frühe Bildung”) gjatë pandemisë së koronavirusit. Projekti mbështet familjet që mbërrijnë në kopsht dhe jep oferta të nivelit të ulët. Gjatë muajve të fundit na është dashur të gjejmë mënyra të reja për të ruajtur kontaktin me ju, familjet. Bashkekzistenca e zakonshme shpeshherë nuk ka qenë e mundur gjatë pandemisë së koronavirusit. Rruga digjitale ka hapur mundësi të reja për ne këtu. Kemi vënë gjithashtu re se rëndësia e mjeteve digjitale në familje është rritur dhe me gjasë do të rritet më tej.

Përdorimi i mediave digjitale nga fëmijët nuk është domosdoshmërisht i keq, por varet “çfarë” përdor dhe “sa shpesh” e përdor. Mund të ndodhë gjithashtu, që përdorimi i mediave në situata të veçanta (p. sh. gjatë izolimit për shkak të koronavirusit) mund të jetë më i gjerë, të cilin ju në familjet tuaja e gjykoni si të drejtë. Përkohësisht kjo është në rregull. Ju duhet të merrni në konsideratë disa gjëra në lidhje me përdorimin e mediave digjitale nga fëmijët. Në vazhdim duam t’ju japim disa këshilla dhe gjithashtu t’ju prezantojmë me një përzgjedhje të përshtatshme të përmbajtjes.





# Cilat media janë të përshtatshme për fëmijët?



Nuk është vendimtar lloji i medias, por përmbajtja dhe si ajo përdoret:

Mediat digjitale janë sot kudo dhe i përkasin përditshmërisë familjare. Shpeshherë ne i konsiderojmë kompjuterët, tabletët ose telefonat inteligjentë si pajisje për lojëra ose për punë. Këto pajisje mund të përdoren shumë mirë dhe në mënyrë shumë kreative dhe ofrojnë mundësi diskutimi me vlerë, kur ju, për shembull, së bashku me fëmijët tuaj shikoni në telefonin tuaj inteligjent fotot e pushimeve dhe shumë të entuziazmuar flisni me njëri-tjetrin për këto përvoja.


Është normale dhe krejtësisht e parrezikshme, që fëmijët tuaj sot të përdorin media të tjera nga ato që ju keni përdorur në moshën e tyre:

Kjo është shumë normale. Por për fëmijët tuaj kjo nuk është fare problem, pasi ata rriten me këto pajisje. Gjithsesi, ajo çfarë është e re, është fakti që fëmijët tuaj rriten me përmbajtje mediash, të cilat janë të disponueshme në çdo kohë dhe në masë të pakufizuar. Ndërsa në të kaluarën keni pritur gjithë kureshtje për njeriun prej rëre, sot ju dhe fëmijët tuaj mund të përdorni me prekje e një butoni shërbime transmetimi, biblioteka mediash ose aplikacione si YouTube. Për këtë arsye përgjegjësia juaj si person edukues rritet, duke shoqëruar fëmijët tuaj përmes një larmie të madhe ofertash dhe t'ju jepni atyre orientimin tuaj, çfarë është e mirë për ta dhe çfarë jo. Për këtë arsye është e rëndësishme të dini, se çfarë shikojnë apo me çfarë luajnë fëmijët tuaj. Kjo vlen veçanërisht kur bëhet fjalë për lundrimin në internet.

Shpeshherë ndryshimet teknologjike vijnë kaq shpejt, sa që ndihemi të pasigurt. Edhe



# Në çfarë mase është konsumimi i medias nga fëmijët i përshtatshëm? Kur nuk është ai më i shëndetshëm?



Nuk bëhet fjalë vetëm për të caktuar një periudhë kohore, përkundrazi duhet të merren më shumë në konsideratë aktivitetet e fëmijëve:

Ashtu si me të gjitha aktivitetet, varet pyetja në lidhje me kohëzgjatjen e përshtatshme me atë se çfarë bëjnë fëmijët tuaj në të vërtetë me mediat digjitale dhe çfarë synojnë. Për shembull, nëse fëmijët tuaj flasin me gjyshërit e tyre përmes një telefonate me video në tablet për ditën e tyre, atëherë kohëzgjatja e duhur e përdorimit të medias është derisa të përfundojë biseda. Nëse jeni duke parë një film me fëmijët tuaj, gjatësia e duhur e përdorimit të medias është gjatësia e filmit. Më mirë të bëni marrëveshje të qarta dhe transparente që në fillim në lidhje me atë që fëmijët tuaj do të bëjnë me mediat digjitale dhe kur do të përfundojë aktiviteti.

Në thelb, fëmijët mund të gjykojnë vetë kur kanë nevojë për një ndryshim dhe duan të lëvizin. Një përjashtim janë lojërat që nuk kanë fund logjik, d. m. th. që janë krijuar për t'u luajtur vazhdimisht. Ju duhet të caktoni një afat kohor për këto lojëra. Në përgjithësi, rekomandohet më pak kohë në ekran sa më të vegjël të jenë fëmijët. Në faqen e internetit të Qendrës Federale për Edukimin Shëndetësor mund të informoheni në lidhje me rekomandimet për përdorimin e dobishëm të mediave televizive.

Probleme me shëndetin shfaqen atëherë, nëse i lini fëmijët tuaj vetëm me përvojat e tyre (negative):

Ndonjëherë fëmijët shqetësohen nga përshtypjet që ne si të rritur as nuk jemi të vetëdijshëm ose që na duken jo problematike në shikim të parë. Disa fëmijë mund të mos jenë në gjendje të durojnë muzikën emocionuese në filma. Fëmijët e tjerë mund të identifikohen aq intensivisht me heronjtë e serialeve, filmave ose lojërave të tyre, sa tremben tej mase kur u ndodhin padrejtësi. Prandaj, kushtojini vëmendje të madhe sinjaleve të fëmijëve tuaj dhe merrni seriozisht shqetësimet dhe frikën e tyre.

Flisni me fëmijët tuaj në lidhje me përvojat e tyre:

Edhe nëse fëmijët tuaj nuk shprehin shqetësime, është e rëndësishme të flisni me ata për ato që kanë përjetuar. Për shembull, gjatë darkës, pyesni fëmijët tuaj se çfarë kanë përjetuar në lojën e tyre kompjuterike ose si e kaluan ditën heronjtë e tyre në serial. Ju do të mësoni shumë nga tregimet e fëmijëve tuaj në lidhje me emocionet, perceptimet dhe preferencat e tyre. Për më tepër, me heronjtë dhe historitë që janë të rëndësishme për ta, fëmijët tuaj do të ndihen të pranuar dhe do të merren seriozisht nga ju.



# Çfarë përmbajtje mediatike është në rregull për fëmijët

Mbështesni kreativitetin dhe kuriozitetin  
e fëmijëve tuaj:

Jepuni fëmijëve tuaj mundësinë të jenë krijues me telefonin inteligjent, kompjuterin ose tabletin e tyre. Ndoshta forma më e thjeshtë e kreativitetit është të bësh foto ose të regjistros video. Jepini vetes mundësinë ta shikoni botën nëpërmjet një seti fotografik safari nga këndvështrimi i fëmijëve tuaj. Do të habiteni se çfarë po fotografojnë fëmijët tuaj. Fëmijët tuaj mund të pikturojnë me *bojë* ose të ndryshojnë fotot e familjes. Si tingëllojnë fëmijët tuaj si të rritur? Si tingëllojnë babai si grua? Këto mund t'i zbulojnë fëmijët tuaj duke regjistruar zëra dhe duke i ndryshuar ato me një konvertues zëri. Ëndërroni së bashku me fëmijët tuaj ëndrrën për të qenë një yll i madh popi. Me aplikacione si *Garageband* ose *Auxy*, ju dhe fëmijët tuaj keni në dispozicion një studio të tërë regjistrimi për të bërë muzikë. Nëse ju pëlqen dhe fëmija juaj është pak më i

madh në moshë, ju së bashku mund të xhironi me aplikacionin *Stop Motion* shumë lehtë një film, ose me aplikacionin *Scratch*, gjuha programuese për fëmijë, të krijoni lojëra të vogla.

Nëse fëmijët tuaj rriten me shumë gjuhë, ata gjithashtu mund të përdorin internetin për të mbajtur kontakt me gjuhën amtare të familjes. Nëse gjermanishtja nuk është gjuha e tyre e parë, ka gjithashtu mundësi për të njohur gjuhën e re. Për shembull, faqja *AMIRA* ofron tregime të shumta për fëmijë në tetë gjuhë, për t'i dëgjuar ose lexuar vetë. Shfrytëzoni rastin për të eksploruar këtë ose oferta të ngjashme me fëmijët tuaj. Sepse fëmijët mësojnë më mirë një gjuhë duke shkëmbyer ide me njerëz të tjerë. Si rezultat, shikimi i videove ose dëgjimi i tregimeve vetëm në një gjuhë të panjohur nuk do të ishte e dobishme për fëmijët tuaj.

Përdorni median digjitale si mundësi për fëmijët tuaj që ata të mbajnë kontakte me shokët apo të afërmit e tyre:

Ndoshta fëmijët tuaj i merr malli për të afërmit që jetojnë larg ose për shokët të cilët janë transferuar. Me përdorimin e mediave digjitale mund t'ju jepni mundësinë fëmijëve tuaj, që fotot të cilat ata i kanë bërë vetë t'ia dërgojnë gjyshit ose gjyshes t'i tregojnë makinat e shpejta, për të cilat ata kanë kaluar gjysmën e ditës duke i ndërtuar, ose për t'u treguar shokëve të gjitha gjërat e çmuara që gjetën në park.

Mos i lejoni fëmijët, të cilët janë në moshën e kopshtit apo shkollës fillore të lundrojnë vetëm në internet:

Fëmijët tuaj mund të mësohen shpejt me median digjitale. Por ata mund të bien shumë lehtë në kurtzet e internetit. Ju mund të flisni me fëmijët që janë në moshë fillore, që në internet ka foto apo filma të cilat nuk janë të përshtatshme për moshën e tij dhe që jo çdo gjë që është në internet është e drejtë, që mund të kushtojë para, nëse ata klikojnë diku në një faqe të panjohur dhe që

duhet të mendohen shumë mirë përpara se të publikojnë foto ose informacione për veten. Në mënyrë që të mësojnë se si të veprojnë me kompetencë me të gjitha këto rreziqe, fëmijët duhet të jenë më të rritur dhe duhet të fitojnë përvojë për një periudhë më të gjatë kohore. Prandaj, rekomandimi ynë urgjent është të mos lejojmë që fëmijët e kopshtit dhe moshës së shkollës fillore të shfletojnë vetëm internetin.

Përdorni masat e disponueshme të sigurisë, që ju ofron pajisja mediatike dhe kontrolloni paraprakisht çfarë lejohet të përdorë fëmija juaj kur është vetëm:

Përdorni në tabletin ose telefonin tuaj inteligjent funksionin "Geführter Zugriff" (për iOS) ose "Bildschirm fixieren (për Android)", të cilat ju lejojnë të hapni vetëm një aplikacion gjatë kohës që përdoret nga fëmija juaj ose aktivizoni modalitetin "në fluturim".

Ju gjithashtu mund të informoheni në faqen e internetit të Deutschen Jugendinstitut e. V. (DJI) ose të "Gutes Aufwachsen mit Medien", se cili aplikacion është i përshtatshëm për fëmijën tuaj.







# Çfarë duhet të keni tjetër parasysht?

## Krijoni kohë balancuese për lëvizje:

Fëmijët ju tregojnë se për çfarë kanë nevojë: fëmijët vetë kanë dëshirë të dalin jashtë dhe të luajnë me shokët, vendin e tretë e zënë lodrat dhe gjërat materiale bashkë me televizorin dhe median digjitale. Merrni parasysht këtë dhe mendoni, se ku mund të lëvizë fëmija juaj mirë brenda në banesë dhe jashtë saj. Ndoshta edhe ju vetë keni nevojë për lëvizje? Atëherë bëni bashkë me fëmijët tuaj gjimnastikë, luani futboll (me top) ose bëni një shëtitje deri në kompleksin tjetër më të afërt.

## Kushtojini fëmijëve tuaj herë pas here vëmendje kur ata luajnë:

Shikojini fëmijët tuaj për 10–15 minuta ndërsa luajnë dhe pastaj thojini çfarë shikoni.

Ju mund të tërhiqeni dhe të çlodheni. Fëmijët do ta shijojnë vëmendjen tuaj dhe më pas ndihen më të lumtur për të vazhduar lojën vetëm. Kjo kohë mund të jetë gjithashtu për ju e bukur, duke u ulur rehatshëm pranë fëmijëve tuaj dhe të zbuloni idetë kreative që ata kanë.

## Mos e përdorni median si shpërblim dhe mos e përdorni atë as si ndëshkim:

Nëse ka konflikte me fëmijët tuaj, atëherë kjo ka të bëjë me shumë gjëra, të cilat fillimisht jo domosdoshmërisht kanë të bëjnë me përdorimin e mediave. Këtu më shumë mund të ndihmojë, nëse ju i sinjalizoni fëmijës tuaj, që është krejt normale, nëse dikush ndihet i inatosur, i mërziur ose nuk është në humor. Ndoshta gjeni diçka, e cila mund të sjellë sërish humor të mirë.

# Këshilla Online

## Lidhje të mëtejshme

[www.klicksafe.de](http://www.klicksafe.de)  
[www.schau-hin.info](http://www.schau-hin.info)  
[www.internet-abc.de/eltern/die-juengsten-im-netz/kleinkinder-und-medien/](http://www.internet-abc.de/eltern/die-juengsten-im-netz/kleinkinder-und-medien/)  
[www.gutes-aufwachsen-mit-medien.de](http://www.gutes-aufwachsen-mit-medien.de)  
[www.kindergesundheit-info.de/themen/medien/mediennutzung/](http://www.kindergesundheit-info.de/themen/medien/mediennutzung/)

## Faqe interneti për fëmijë dhe motorë kërkimi

[www.fragfinn.de](http://www.fragfinn.de)  
[www.blinde-kuh.de](http://www.blinde-kuh.de)  
[www.klicksafe.de/fuer-kinder/](http://www.klicksafe.de/fuer-kinder/)  
[www.seitenstark.de](http://www.seitenstark.de)

## Aplikacione dhe përmbajtje

[www.gutes-aufwachsen-mit-medien.de/informieren/datenbank-fuer-kindermedien](http://www.gutes-aufwachsen-mit-medien.de/informieren/datenbank-fuer-kindermedien)  
[scratch.mit.edu/parents](http://scratch.mit.edu/parents)  
[www.amira-lesen.de](http://www.amira-lesen.de)





# KITA-EINSTIEG HAMBURG



Gemeinsam  
groß werden!

[www.kita-einstieg-hamburg.de](http://www.kita-einstieg-hamburg.de)

Arbeitsgemeinschaft  
der Freien Wohlfahrtspflege  
Hamburg e. V.

## AGFW

Koordinierungsstelle Kita-Einstieg Hamburg

Tel. 040/228 64543-0


[kita-einstieg@agfw-hamburg.de](mailto:kita-einstieg@agfw-hamburg.de)

[www.kita-einstieg-hamburg.de](http://www.kita-einstieg-hamburg.de)

Një projekt i përbashkët i ofruesve të Qerdhve të Hamburgut



Mbështetur nga



Dëftues botimi

Botuesi: Elbkinder Vereinigung Hamburger Kitas gGmbH, Oberstraße 14b, 20144 Hamburg, Përpiluar nga André Becker dhe Gesa Löbner-Bonk, Fotot: Wolfgang Huppertz (S. 8, 12), istock.com (S. 1, 2, 4, 11, 15), Krijimi: Carsten Kudlik, Lothar Ruttner, [www.kudlik-ruttner.de](http://www.kudlik-ruttner.de), Shtypur: RESET ST. PAULI Druckerei GmbH, Hamburg, Hamburg, Tetor 2021, [www.elbkinder-kitas.de](http://www.elbkinder-kitas.de)